



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:270170

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05730986

K.DH.SH.II.nr.455/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Unikat” Shpk me seli në Pejë me numër të biznesit 70432008, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Afrim Salihu, avokat në Prishtinë, kundër të paditurëve Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Erëleta Popaj, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.14/22 të datës 19.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e paditësit “Unikat” ShPK me seli në Pejë, e datës 12.01.2024, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.14/22 të datës 19.12.2023, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m

Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.14/22 të datës 19.12.2023, me aktgjykimin e ankimuar ka vendos si në vijim; nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ka vendosur, Refuzohet në tërsi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Unikat” Shpk me të cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi PSH.nr.336/14 i datës 03.10.2014 i nxjerr nga i padituri i dytë Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Kontrata e datës 22.08.2014 për aktivitetin e prokurimit me nr. 214-14-148-111 si dhe që të obligohen i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Ministria e Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës që paditësit “Unikat” Shpk, në mënyrë solidare ti kompensojnë dëmin material në formën e fitimit të humbur në vlerë 851,190.08€ dhe në formën e dëmit real në vlerë prej 29,500.00€. ndërsa secila palë i bartë shpenzimet e veat procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit së autorizuar, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta aprovoj ankesën dhe lëndën ta kthej në rigjykim ose të vendos që ta anuloj aktgjykimin e Shkallës së Parë dhe të vendos me aktgjykim sipas pretendimeve sipas kësaj ankese.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Panelit Shqyrtues të Prokurimit Publik, PSH.nr.366/14 të datës 03.10.2014, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, është refuzuar ankesa e operatorit ekonomik “Unikat” me seli në Pejë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Uniformë të re, për PK-në, PK 214/14/148/111, të iniciuar nga autoriteti kontraktues Policia e Kosovës si e pa bazuar. Në pikën II, Mbetet në fuqi vendimi i autoritetit

kontraktues (AK), Policia e Kosovës për dhënien e kontratës, lidhur me procedurën e prokurimit me titull “Furnizim me Uniform të re për PK-në PK 214/14/148/111, si i bazuar dhe njëherit i lejohet autoritetit kontraktues që të vazhdojë më tutje me këtë aktivitet të prokurimit. Nën pikën III, Mos respektimi i këtij vendimi detyron panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 25.8 dhe nenit 130 të LPP-së nr.04/L-042 të ndërmarr masa ndaj autoritetit kontraktues, të cilat janë të parashikuara në nenet e lartpërmendura të LPP-së. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Nën pikën IV. Operatorit ekonomik ankues “Unikat” me seli në Pejë, konform nenit 118.3 të LPP-së i konfiskohet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën prej 500.00€ (pesëqind euro).

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 03.11.2014, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur gjykata iu referua nenit 7 par.1 dhe 2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik me ç’rast, gjykata konstaton se i padituri i parë AK, me rastine zhvillimit të aktivitetit të prokurimit “Furnizim me uniform të re në Policinë e Kosovës” kishte trajtuar të gjithë OE në mënyrë të barabartë jo diskriminuese dhe kishte vepruar në mënyrë transparente gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit, si dhe i padituri i dytë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike me rastine nxerrjes së vendimit PSH.nr.336/14 të datës 03.10.2014 më të cilin ka lënë në fuqi njoftimin për dhënien e kontratës dhe ka lejuar vazhdimin e aktivitetit të prokurimit. Gjykata përmes raportit të ekspertit shqyrtues të datës 16.09.2014 ka vërtetuar se paditësi kishte qenë i pa përgjegjshëm pasi që nuk kishte plotësuar disa nga specifikimet tenike të përcaktuara në dosjene tenderit, respektivisht nuk ka përmbushur specifikimet teknike të përcaktuara në pikën 1.1, 1.4, 1.5, 1.7, 2.1, 2.4, 2.7, 3.6, 4.1, 4.5, 4.6 dhe 4.8 të dosjes së tenderit. Nga ky raport gjykata ka konstatuar se OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit Sh.H., për shqyrtimin të ankesave lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me uniform të re në Policinë e Kosovës” ku në përgjigje të pretendimeve ankimore të operatorëve, ka theksuar se AK me rastin e zhvillimit të aktivitetit të prokurimit ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së me ç’rast

ka rekomanduar që AK të vazhdoj me procedurën e prokurimit. Nga ekspertiza financiare e harutar nga eksperti Vehbi Imeri e punuar me datë 10.10.2023 e dorëzuar në gjykatë me datë 12.10.2023 gjykata ka konstatuar se dëmi i pretenduar material që eksperti ka konstatuar sipas specifikacioneve që ka përcjellë paditësi është 29,500.00€ ndërsa fitimi i humbur sikurse paditësi do të ishte rekomanduar për kontratën, që do të realizonte kontratën është përlogaritur në vlerë prej 851,190.08€, gjykata nga provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar ka konstatuar se i padituri i dytë ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore formale dhe materiale si dhe drejtë ka konstatuar gjendjen faktike më rastine refuzimit të ankesës së paditësit dhe lejimit të aktivitetit të prokurimit “Furnizim me uniforme të re në Policinë e Kosovës” pasi që paditësi ndonëse kishte ofertuar me çmimin më të ulët sesa OE fiturës i njëjti kishte qenë i pa përgjegjshëm për shkak të mos plotësimit të specifikave të tenderit. Gjykata vlerësoi edhe provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe pretendimet tjera të paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë seancave gjyqësore, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe në procedurë të konfliktit administrativ, andaj gjykata refuzoi kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e dëmit materiale real në vlerë prej 29,500.00€ dhe fitimin e humbur në shumë prej 851,190.08€ për shkak se kompensimi i dëmit të pretenduar material dhe në emër të fitimit të humbur nuk ka bazë ligjore. Andaj, bazuar në nenet 13, par.1 nën par 1.12 lidhur me par.5 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 41 dhe 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i’u ka referuar dispozitave ligjore nga neni 59 par.1 dhe 4 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik. Sepse me nenin Në nenin 59 par.1 është përcaktuar se “*Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave*” dhe par.4. “*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe*

*në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.*

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata me vendimin e saj gabimisht ka refuzuar padinë dhe kërkesëpadinë, sepse gjykata nuk i ka analizuar pretendimet e paditësit të cilat janë shtjelluar së së bashku me gjykatën, gjatë shqyrtimeve gjyqësore, prandaj gjykata është dashur ta aprovoj padinë dhe të anuloj aktet administrative duke i anuluar vendimet me aktgjykim, sipas kërkesës së paditësit me precizim të padisë së datës 14.12.2016 sepse vendimi i ankimuar me padi në gjykatë përmban shkelje ligjore të cilat janë elaboruar në ankesë dhe në bazë të fakteve të cilat i kemi apostrofuuar iu është bërë e lehtë gjykatës marrja e vendimit meritore nga pretendimet e paditësit të cilat kanë bazë ligjore. Këto pretendime ankimore kolegji nuk i aprovoi, ngase Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë i është referua nenit 27 par.1, si dhe nenit 28 par 1 dhe 2 si dhe paragrafi 8 të Ligjit për Prokurimin Publik 04/L-042. Po ashtu gjatë vlerësimit të pretendimeve lidhur me kriteret për dhënien e kontratës Dhoma e Shkallës së Parë iu referua nenit 52 par.1, 3 dhe 4, si dhe nenit 60 të LPP-së. Andaj, për këtë arsye Dhoma e Shkallës Dytë i vlerësoi si të pa bazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat nuk kanë gjetur mbështetje në dispozitat ligjore materiale të cilat rregullojnë këtë çështje dhe nuk kanë qenë në përputhje me provat e administruara për të vendosur ndryshe në këtë çështje administrative.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata në vendimin e ankimuar nuk i kishte marr për bazë shkeljet e dispozitave ligjore nga paneli shqyrtues i OSHP-së që në bazë të kompetencave të LPP për OSHP dhe në bazë të kompetencave të OSHP-së nga nenet ka bërë shkelje të dispozitave ligjore. Këto pretendime ankimore kolegji nuk i aprovoi, ngase Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se Dhoma e Shkallës së Parë ka bërë shkelje ligjore. Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit kolegjit aktgjykimi i ankimuar i Dhoma e Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, kolegji i vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë të paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.455/24, me datë 24.05.2024

Kryetare e kolegjit,  
Franciska Zhitija Ymeri